

## Lista e verifikimit për planifikimin e një bisede prindër-mësues

Nëse prindërit duan të marrin nismën për një takim informues, ne rekomandojmë të përgatiten dhe të procedojnë sipas listës së verifikimit më poshtë. Në rast se mësuesi kërkon një bisedë, njohja e hapave për të ndihmuar në formimin dhe kontrollin e bisedës është shumë e dobishme.

Çfarë duhet bërë?	Udhëzime mbi zhvillimin	Shënime
1. Përgatitja e përmbajtjes së bisedës	<p>Prindërit marrin parasysh këto:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Si e shohim fëmijën tonë si nxënës?</b></li> <li>● <b>Si ndihet fëmija ynë për situatën që do të diskutohet?</b></li> <li>● Çfarë duam t'i themi mësuesit apo mësueses?</li> <li>● <b>Çfarë duam të mësojmë?</b></li> </ul> <p>Prindërit formulojnë pyetje për mësuesin apo mësuesen dhe i shkruajnë ato..</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>A nevojitet ndihmë me përkthimin?</b> → Pyesni në shkollë ose këshillin e prindërve. MOS e përdorni fëmijën në fjalë për përkthim.</li> </ul>	
2. Kontaktoni me mësuesin apo mësuesen	<p>Shprehni dëshirën tuaj për një bisedë: personalisht, me shkrim ose telefon (shabllonin e gjeni në <a href="http://www.wegweiser-bw.de">www.wegweiser-bw.de</a>)</p>	
3. Caktoni një takim dhe vend	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Bini dakord për <b>ditën, orën dhe kohëzgjatjen maksimale</b>: në "orarin e zakonshëm të konsultimit" të mësuesit/mësueses apo individualisht? <b>mos "hyni"</b> në klasë gjatë orës së mësimi. Shmangni bisedat spontane në korridor. Mbani parasysh kohët e pushimit</li> <li>● Pyesni për <b>dhomën</b>: pyesni mësuesit se ku zhvillohet biseda; nëse nuk e dini dhomën, kërkonit udhëzime të shkurtra.</li> <li>● <b>Fikni celularin</b></li> <li>● Në fund fare: Njoftoni për shoqërimin e një përkthyesi</li> </ul>	
4. Niseni bisedën në mënyrë aktive	<p>Miqësisht, por qartazi:</p> <p><b>"E kemi kërkuar këtë bisedë, sepse duam të mësojmë më shumë dhe të shkëmbejmë ide me ju rreth..."</b></p> <p>(Në rast se keni ndonjë problem, ju rekomandojmë: të përdorni njoftimet ose listën e verifikimit për ndihmë)</p>	